



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 16/11 , DATË 01 / 08 /2023

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIMIN E STATUSIT
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR”
PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “PËR NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E
ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK (TEDA) SPITALLË
DHE INSTALIMIN E PARKUT FOTOVOLTAIK ME FUQI 40.54 MWP, DURRËS”
ME SUBJEKT APLIKUES SHOQËRINË “NOA ENERGY TRADE” SHPK, ME
NUIS/NIPT: L42203031A**

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 13, nenit 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/a,d të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti i investimit propozon ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Spitallë dhe instalimin e parkut fotovoltaik me fuqi 40.54 MWP, në një sipërfaqe 49.1 Ha, në ZK 8517, miratuar si ‘Zonë e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik’ me VKM Nr. 262, datë 06.04.2016, si dhe të ndryshuar me VKM Nr. 1111, datë 24.12.2020.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 30,000,000 (tridhjetë milion) Euro.
- Pasuritë e paluajtshme që preken nga projekti i investimit të propozuar ndodhen në ZK Nr. 8517, miratuar si ‘Zonë e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik’ me VKM Nr. 262, datë 06.04.2016, si dhe të ndryshuar me VKM Nr. 1111, datë 24.12.2020.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE
VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Spitallë dhe instalimin e parkut fotovoltaik me fuqi 40.54 MWP”, Durrës”, me subjekt investues shoqërinë “NOA Energy Trade” shpk, me NUIS/NIPT: L42203031A në procedurën e asistuar dhe mbështetjen që ofron ky status.

2. Për zonën në fjalë aktualisht ka plane të tjera prioritare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe Bashkisë Durrës.
3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
FRIDA KRIFCA

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT
ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS
SOKOL NANO